



Planuar / Doretuar Priljena/Prodato Received/Delivered	18 - 01 2023	3	viti god Year
Organ /Mjesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPMSHCK	492/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1027/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1027/2022 të datës 18.11.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 14.11.2022, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1027/2022 e datës 18.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Njoftimi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit i datës 18.11.2022 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa *Anulohet* procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë" e shpallur përmes konkursit të datës 12.10.2022 nga Komuna e Prizrenit si dhe çdo akt tjetër juridik që rrjedh nga kjo procedurë.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prizrenit, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit këtij vendimi brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditore nga dita e pranimit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi, me datë 18.11.2022 përmes e-mailit ankesa.kpmschck"rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7217/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1027/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 14.11.2022.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se vendimi në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me kërkesën që të anulohet konkursi i datës 12.10.2022 pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e shpalljes së konkursit-lëvizje paralele për dy herë radhazi ka vepruar në kundërshtim me dispozita e nenit 52 paragrafi 1 të së njëjtës rregullore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar ankesën për përgjigje në Komunën e Prizrenit, ndërsa me datë 28.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 28.12.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.202/2022 për mes të cilit vendim ankesës A.nr.1027/2022 të datës 18.11.2022 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 18.11.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.11.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill; Konkursin e datës 12.10.2022; Vendimin e datës 04.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Formularin për paraqitjen e kërkesës apo ankesës i datës 10.11.2022; Ankesën e ankuesit të datës 10.11.2022 parashtruar në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Vendimin për transferimin e përkohshëm i datës 01.09.2022; Vendimin e datës 14.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Konkursin e datës 25.05.2021; Vendimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore 25.06.2021; Konkursin e datës 09.02.2022; Njoftimin e datës 18.11.2022 për kandidaten e suksesshme; Përgjigja në kërkesë e datës 18.11.2022; Kontratën e punës së ankuesit i datës 01.01.2005; Aktvendimin e datës 14.06.2006 me numër:01-112-103; Akt emërimit e ankuesit i datës 01.01.2012; Aktvendimin e datës 02.06.2015 të nxjerrë nga Kryetari i Komunës; Akt emërimit e ankuesit të datës 02.06.2015; Aplikacionin e ankuesit i datës 03.11.2022; Diplomën e ankuesit të datës 07.01.1991; Shtojcën e diplomës lëshuar nga Universiteti i Prishtinës e datës 5.12.2013 me numër:3479/2013; Çertifikatën e datës 28 maj 2021; Çertifikatën e datës 26.01.2018; Çertifikatën e muajit mars 2014 lëshuar nga KS-Kosova; Çertifikatën e datës 25.02.2013; Çertifikatën e datës 18.06.2009; Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë i datës 06.01.2021;Vërtetimin e datës 18.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimin për transferimin e përkohshëm për zëvendësimin e pozitës i datës 01.09.2022, Vendimin e Kryetarit të Këshillit me shifër VK.nr.202/2022; E-mailin e datës 18.01.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin me materialet e bashkëngjitura, Planin e Personelit për vitin 2022 të Komunës së Prizrenit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar*, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Prizrenit, me datë 12.10.2022 ka shpallur konkursin për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative* me numër reference RN00010154 (*lëvizje brenda kategorisë*), ndërsa kriteret e konkursit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar-Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ETC apo ekuivalente me to, Fakulteti: IT/Inxhinieri e softuerëve dhe programim; dhe Përvoja e punës së kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi në konkursin përkatës ka aplikuar me datë 03.11.2022, ndërsa sipas Vendimit për verifikimin paraprak të datës 04.11.2022 të nxjerrë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk i ka përmbushur kriteret e konkursit, më pas ankuesi kundër vendimit për verifikimin paraprak të datës 04.11.2022 ka parashtruar ankesë të brendshme në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e cila më pas ka shqyrtuar ankesën e ankueses dhe përmes Vendimit të datës 18.11.2022 me shifër RAN0008853 ka refuzuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se i njëjti nuk e ka plotësuar njërën nga kriteret e konkursit, gjegjësisht ankuesi nuk kanë qenë i konfirmuar në detyrë në pozitë udhëheqëse me rastin e aplikimit dhe e i njëjti sipas aktit të emërimit është i konfirmuar në detyrë në kuadër kategorinë profesionale-Zyrtarë i lartë për energjetike kështu që nuk ka përmbushur kushtet e konkursit të përcaktuara me nenin 41 paragrafi 2 në paragrafi 2.1 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku për caktohet se: *"Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon"*,

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me anulimin e konkursit ka analizuar dispozitat e nenit 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë"* si dhe nenit 52 paragrafi 1 dhe 3, të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se *"1. Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë, 3. Konkurrimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil"*, dhe ka ardhur në përfundimin se Komuna e Prizrenit me rastin e shpalljes së konkursit të datës 12.10.2022 për pozitën *"Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative"*, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të ligjit material, ngase Komuna e Prizrenit me datë 25.05.2021 kishte hapur konkursin e tipit-lëvizje brenda kategorisë për të njëjtën pozitë konkursi i cili kishte dështuar për shkak të mungesës së kandidatëve, nga rrjedh se institucioni e kishte konsumuar paraprakisht veprimin procedural të rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë të përcaktuar sipas nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nga rrjedh se me rastin e mos hapjes së konkursit të tipit ngritje në detyrë-avancim siç përcaktohet

me nenin 39 paragrafi 1 i të njëjtit ligj, Njësia për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik gjegjësisht Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit material.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit me datë 18.01.2023 ka pranuar plotësimin e përgjigjes lidhur me pretendimet e palës paditëse nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, me arsyetimin se konkursi është hapur i natyrës-lëvizje brenda kategorisë për shkak që konkursi i natyrës së njëjtë për pozitën e njëjtë i hapur në vitin 2021 ishte anuluar përmes Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit i datës 18.03.2022 me arsyetimin se meqenëse për procedura e rekrutimit për pozitën *"Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative"*, kishte kaluar viti kalendarik dhe është miratuar plani i ri personelit për vitin 2022. Mirëpo, Kolegji i Këshillit sjell në vëmendje se dispozitat e nenit 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik kanë përcaktuar qartë rrjedhën procedurale se si plotësohet një e pozitë e lirë e punës në kuadër të shërbimit civil, gjegjësisht Vendimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit i datës 18.03.2022 sikurse edhe Plani Vjetor i Personelit për vitin 2022 nuk mund ta përcaktojnë ndryshe nga fryma e ligjit këtë çështje dhe se veprimet e tilla nuk mund të përlligjen. Po ashtu, pala ankuese në cilësi të provave të lëndës ka ofruar dëshmi shtesë sikurse shkresën njoftuese të datës 25.06.2021 se konkursi i shpallur me datë 25.05.2021 me numër reference:RN00006956 për pozitën *"Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative"* anuluar për shkak se nuk ka aplikuar asnjë kandidatë në këtë procedurë, nga rrjedh se i është hapur rruge zbatimit të nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, andaj Kolegji i Këshillit mbetet pran konstatimit të dhënë se Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit material.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se shpallja e konkursit të datës 12.10.2022 nga Komuna e Prizrenit është bërë në kundërshtim me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht ky veprim ka konsumuar veprimet e shkeljes së parimeve të përgjithshme të pranimit të zyrtarëve publik të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 1 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: *"Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive"* ngase ua ka pamundësuar që në këtë procedurë të rekrutimit të kandidojnë të gjithë nëpunësit civil të një kategorie me të ulët sesa pozita që është shpallur për rekrutim dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar ngase konkursi është shpallur në kundërshtim me dispozitat e ligjit material të përcaktuar si më lartë, ndërsa procedura e rekrutimit është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Zyrtarëve Publik, nuk është lëshuar në shqyrtim të ligjshmërisë së Vendimit të datës 18.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit përmes të cilit ankuesit i ishte refuzuar ankesa e datës 10.11.2022 ndërlidhur me refuzimin e aplikacionit në fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve të kandidatëve në procedurë, për shkak se konstatimi i ligjshmërisë ose jo e aktit të goditur përmes kësaj ankese nuk do të ndryshonte natyrën vendimmarrëse në këtë procedurë ndërlidhur me çështjen

paraprake-kryesore, pra me mënyrën e shpalljes së konkursit. Po ashtu, Kolegji i Këshilli kishte konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 18.11.2022 e kishte publikuar Njoftimin për kandidatin e suksesshëm, pavarësisht faktit që Vendimi i datës 18.11.2022 i Njësia së Burimeve Njerëzore i nxjerrë ndaj ankuesit e përmbante këshillin juridike të se drejtës së ankimimit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj ky veprim është në kundërshtim me nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën", ngase Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore është dashur të pret kalimin e afateve ankimore që ndërlidhjen me zgjidhjen e ankesave, përpara se të ndërmarra hapa të tjerë me qëllim të përmbjlljes së procedurës së rekrutimit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1027/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

